REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROTOKOLLI 15

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 27.08.2026 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. **Projekt-Vendim** "Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin gusht 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%."
4. **Projekt-Vendim** "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë".
5. **Projekt-Vendim** "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë".
6. **Projekt-Vendim "**Për miratimin e Projekt Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029 të Bashkisë Kolonjë."
7. **Projekt-Vendim**"Për miratimin e bashkëfinancimit të projektit "Vila e Rilindjes".
8. **Projekt-Vendim** "Për autorizimin e kryetarit të bashkisë Kolonjë ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhje kontrate para noterit për shitjen e truallit të objektit."
9. **Projekt-Vendim** "Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026" Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026".

Të pranishëm: E. Xhelili, B.Jashari, G.Tafili, P.Çunge, Z.Meto, S.Kodra, I.Hodo , I.Milo, E.Avdi, , S.Larti, H.Iljazi.
Mungon: E. Xhelili, A.Tartari, A.Zeneli, E.Çikopana,T.Çaçani.

E. Xhelili:Përshendetje, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe, duke konstatuar praninë e anëtarëve të Këshillit, deklaroj të hapur mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak.
E. Xhelili: Përpara shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, ju lutem të deklaroni nëse ndonjëri prej jush ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit lidhur me ndonjërën prej pikave që do të shqyrtohen në këtë mbledhje.
P.Çunge: Nuk kemi konflikt interesi.
E. Xhelili: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015. Jeni dakord me rendin e ditës?
Pro 11 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikes së dytë "Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 27.08.2026 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës". Jeni dakord me piken dy të rendit të ditës?

Pro 11 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikes tre "Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin gusht 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%."
P.Çunge: Kemi një refuzim nga sistemi për arsye se kryefamiljari ka filluar punë.
E. Xhelili: Jeni dakord për miratimin e pikes së tretë të rendit të ditës?
Pro 11 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikes katër "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë".
E. Xhelili: Jeni dakord për miratimin e pikës katër të rendit të ditës?
Pro 11 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës pesë "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi Rezervë i Bashkisë".
E. Xhelili: Jeni dakord për miratimin e pikes pesë të rendit të ditës?
Pro 11 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikes gjashtë "Për miratimin e Projekt Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029 të Bashkisë Kolonjë."
E.Duro (Drejtor Finance): Në projekt dokumentin të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029 të Bashkisë Kolonjë nuk ka ndyshime, pervec ndryshimit të kalimit të transferimit të qendrës kulturore "Fan Noli" dhe klubit sportiv "Gramozi" pranë shoqërisë tregtare "Green Kolonja.
Z.Meto: Buxheti i planifikuar nga Bashkia Kolonjë qendrës kulturore "Fan Noli" dhe klubit sportiv "Gramozi" kalojnë për menaxhim pranë shoqërisë tregtare "Green Kolonjë"?
E.Duro (Drejtor Finance): Po buxheti kaloj te shoqëria "Green Kolonja".
E. Xhelili: Jeni dakord për miratimin e pikes së gjashtë të rendit të ditës?
Pro 11 Kundër 0 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikes shtatë "Për miratimin e bashkëfinancimit të projektit "Vila e Rilindjes".
Z.Meto: A mund të kemi më shumë informacion rreth këtij projekti?
Xh.Kalemaj (Specialiste e Njësisë së Integrimit): Projekti financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bazë të thirrjeve që u hapën në qershor për aplikime. Vlera totale e projektit është 26,400,000 lek ku 10% e vlerës totale duhet të jetë bashkëfinancim nga bashkia në vlerën prej 2,400,000 lek. Ky është një projekt shumë inovativ për turistët dhe për Kolonjën. Do të ndërtohet një ambient ku turistët do të kenë mundësi të bashkëbisedojnë virtualisht me Rilindasit Kolonjarë.
I.Hodo: Ku do të sigurohet bashkëfinancimi?
Xh.Kalemaj (Specialiste e Njësisë së Integrimit): Është i parashikuar në buxhet në kodin e projekteve.
E. Xhelili: Jeni dakord për miratimin e pikes shtatë të rendit të ditës?
Pro 11 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikes tetë "Për autorizimin e kryetarit të bashkisë Kolonjë ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhje kontrate para noterit për shitjen e truallit të objektit."
L.Bendo (Specialiste e Urbanistike): Lidhjen e kontratës së shitjes së truallit me qytetarin Sami Meko, për pasurinë me nr. pasurie 6/136, Z.K 1594, qyteti Ersekë sipërfaqen e truallit 320m^2 (sipas planimetrisë të shesh ndërtimit banesë 2 katëshe Nr.77, Blloku Nr.1, për në Qytetin e Ersekës.
E. Xhelili: Është procedura që kemi ndjekur.
H.Iljazi: Nuk jam dakort me projekt vendimin.
E. Xhelili: Jeni dakord për miratimin e pikes tetë të rendit të ditës?
Pro 9 Kundër 2 Miratohet
E. Xhelili: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikes nëntë "Në vendimin nr.152, datë.22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e këshillit bashkiak nr.32 datë.20.02.2026" Për rishqyrtim të vendimit nr 27 datë 13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026".
E.Duro (Drejtor Finance): Fondet do të merren nga diferencat e krijuara në fondin e pagave, si rezultat i vëndeve vakante në strukturën e Bashkisë Kolonjë, për periudhën Janar-Gusht të vitit 2026, duke bërë të mundur përdorimin e tyre për nevoja të tjera të parashikuara në buxhet. Rishpërndarja e shumës 2,170,000 lekë në favor të SH.A. "GREEN KOLONJA", bazuar në kërkesën e Administratorit të shoqërisë, me shkresën nr. 192 Prot., datë 09.09.2026, "Kërkesë për sigurimin e fondeve për realizimin e dy projekteve të miratuara në parim". Nga kjo shumë, 1,999,685.39 lekë do të përdoren për realizimin e dy projekteve të paraqitura nga SH.A. "GREEN KOLONJA".Shuma 999,780 lekë për projektin "Ndërtimi i sistemit të vaditjes me sprucator për Fermën e Arorëve", për krijimin e një sistemi vaditjeje dhe për përmirësimin e kushteve të prodhimit bujqësor dhe shuma 999,905.39 lekë për projektin "Përgatitja e tokës dhe mbjellja e fidanëve të pemëve të lajthisë", për përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e fidanëve të lajthisë. Pjesa e mbetur e fondit, në shumën 170,314.61 lekë, do t'i vihet në dispozicion SH.A. "GREEN KOLONJA" për mbulimin e shpenzimeve të tjera të nevojshme për zhvillimin dhe vijimin e aktivitetit të shoqërisë, sipas nevojave të saj.Vlera 500,000 lekë e marrë nga programi buxhetor 04260 "Shërbimi pyjor" por nga fondi i pagave sic është përmendur më sipër, do të kalojë po në programin buxhetor 04260 Kapitulli 01, por në llogarinë ekonomike 2300000, për investime, konkretisht për projektin "Hartim Plan Mbarështimi", me kod projekti 1200135. Ky fond do të shërbejë për likujdimin në kohë të planit të Mbarështimit dhe për mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për vitin tjetër.Vlera 600,000 lekë e marrë nga programi buxhetor 09120 "Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor" por nga fondi i pagave, sic është përmendur më sipër, do të kalojë po në programin buxhetor 09120, Kapitulli 01, por në llogarinë ekonomike 2310000, si shtesë fondi për projektin "Rikonstruksion Kopshti Marie Gjergo", me kod projekti 1200196. Fondi do të përdoret për tiu shtuar fondit nga Granti i Performancës për vijimin e punimeve për rikonstruksionin e kopshtit "Marie Gjergo".Vlera 800,000 lekë e marrë nga programi buxhetor 09230 "Arsimi Parauniversitar dhe konvikti", por nga fondi i pagave, sic është përmendur më sipër, do të kalojë në programin buxhetor 09230 Kapitulli 01, por në llogarinë ekonomike 2310000, për "Blerje paisje dhe orendi për konviktin". Fondi do të përdoret për blerjen e pajisjeve, orendive dhe materialeve të nevojshme për përmirësimin e kushteve të qëndrimit në konvikt të nevojshme për akomodimin e nxënësve.

Z.Meto: A ka bashëpunim SH.A. "GREEN KOLONJA" me drejtorinë e shërbimeve në bashkine Kolonjë sepse pas keti krijimi që u bë pastrimi nëpër fshatra duhet të ishte shembull.

E.Duro (Drejtor Finance): Arsyeja e kalimit është bashkëpunimi dhe menaxhimi sa më efektiv.
Z.Meto: Në mbledhje e radhes duam informacion nga drejtoria e Shërbimit public dhe nga administratori i SH.A. "GREEN KOLONJA".
E. Xhelili: Jeni dakord për miratimin e pikes nëntë të rendit të ditës?
Pro 11 Kundër 0 Miratohet

Proces-Verbali i datë 21.09.2026 është firmosur nga 11 anëtarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT
INSUIDA ORHANAS

KRYETAR I KËSHILLIT
ERALDO XHELILI